



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 13
QERSHOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE 13.
JUNA 2008. GODINE

Qershor – Juni
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të pestë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtje të Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës,
- 1.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale,
- 1.4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës,
- 1.5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë,
- 1.6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave,
- 1.7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
- 1.8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë,
- 1.9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet publike dhe
- 1.10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2008.

D n e v n i r e d:

2. Drugo razmatranje Pete Grupe Nacrta Zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:

- 1.1. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o Raspuštanju Kosovskog Zaštitnog Korpusa
- 1.2. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o Službi u Bezbednosnim Snagama Kosova
- 1.3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2006/50 o Rešavanju Zahteva koji e Odnose na Privatnu Nepokretnu Imovinu, Uključujući Poljoprivrednu i Komercijalnu Imovinu
- 1.4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2005/20 o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2001/35 o Penzijskom Fondu Kosova
- 1.5. Drugo Razmatranje Nacrta Zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2005/2 o Uspostavljanju Nezavisne Komisije za Rudnike i Minerale
- 1.6. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2004/49 o Aktivnostima Pružanja Usluga Vodosnabdevanja, Kanalizacije i Odnosnja Smeća
- 1.7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A

2003/16 o Proglashenju Zakona o Telekomunikacijama koji je Usvojila Skupština Kosova

- 1.8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Skupštine Kosova 2004/9 o Regulatoru Energije
- 1.9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Javnim Preduzećima
- 1.10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Izmeni UNMIK Uredbe 2008/13 o Usvajanju Konsolidovanog Budžeta Kosova i Autorizovanih Rashoda za Periodu 1 januar do 31 decembra 2008.

A g e n d a:

1. First reading of the fifth's Group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's Proposal, based on the Special procedure:

- 1.1. Second reading Draft Law on Dissolution of the Kosovo Protection Corps,
- 1.2. Second reading Draft Law on Service in the Kosovo Security Force,
- 1.3. Second reading Draft Law on amending UNMIK Regulation 2006/50 on the Resolution of Claims Relating to Private Immovable Property, Including Agricultural and Commercial Property,
- 1.4. First reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation 2005/20 Amending UNMIK Regulation 2001/35 on Kosovo Pensions Trust,
- 1.5. Second reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation No. 2005/2 on the Establishment of the Independent Commission for Mines and Minerals,
- 1.6. Second reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation 2004/49 on the Activities of Water, Wastewater and Waste Services Providers,
- 1.7. Second reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation No. 2003/16 on the Promulgation of a Law adopted by the Assembly of Kosovo on Telecommunications,
- 1.8. Second reading Draft Law on Amending Kosovo Assembly Law No. 2004/9 on the Energy Regulator,
- 1.9. Second reading Draft Law on Publicly Owned Enterprises,
- 1.10. Second reading Draft Law on Amendment of UNMIK Regulation No. 2008/13 on the approval of the Kosovo Consolidated Budget and Authorizing Expenditures for the period 1 January to 31 December 2008.

Seancën plenare e drejtoi Kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**.

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra dhe ministra,

Me kërkesë të Grupit ad-hoc, seancën po e shtyjme për 15 minuta. Një njoftim, në kutitë e juaja e keni Kushtetutën e re të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, seancën e drejtoi anëtari i Kryesisë, Xhavit Haliti.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Me pak vonesë po e vazhdojmë seancën. Vonesat janë krijuar nga Komisioni ad-hoc gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

Në mbledhje janë të pranishëm 77 deputetë.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangien nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, në seancën e sotme plenare do të procedohen për lexim të dytë projektligjet e miratuara dje, më 12 qershor në leximin e parë, si dhe propozimi që e ka bërë Qeveria e Kosovës për miratimin urgjent dhe shqyrtimin e projektligjeve për ndryshim të 7 ligjeve, do të thotë materiali është shpërndarë, do të shtohet vetëm një fjalë lidhur me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve.

A pajtoheni që të procedojmë sipas procedurës paraprake me ligjet.
Ju ftoj në votim formal. “Kundër”, s’ka asnjë, abstenim, s’ka.
Konstatoj që me shumicë absolute miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpërbërjen e trupave mbrojtjes të Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisioni u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Fehmi Mujata që në emër të Komisionit ad-hoc të arsyetojë raportin me rekomandime.

Ju njoftoj që në sallë janë 80 deputetë.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti kryeses!
Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,
Të nderuar deputetë dhe deputete,

Komisioni ad-hoc, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, të datës 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2008 shqyrtoi projektligjet e grupit të pestë

nga propozimi i Marti Ahtisarit, të propozuara nga Qeveria, dhe Kuvendi vendosi t'i paraqesë këtë Raport:

Ju po e shihni se në shumicën prej projektligjeve që i kemi shqyrtuar dje, në parim, nuk ka ndonjë amendament dhe ndryshim, por megjithatë, çështjet të cilat Komisioni i ka shqyrtuar dhe i ka trajtuar, kanë nxjerrë një debat të gjerë, do të thosha edhe përmbajtjesor, për sqarimet e çështjeve të cilat nuk kanë qenë mjaft të sqaruara brenda Komisionit dhe vendimet që janë marrë.

Prandaj, Komisioni ka shqyrtuar edhe Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit të telekomunikacionit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin e Projektligjit, si thuhet, pa ndryshime, por në fakt, Komisioni ad-hoc, në pikën 2, nëse vëreni tek ju, ka shqyrtuar propozimet e Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit, të miratuara, në parim, në seancën e parë plenare, më 12 qershor 2008, dhe të njëjtat nuk i përkrah për arsye se mendon që propozimi i parë është rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kurse propozimi i dytë është rregulluar me Ligjin për ndërmarrjet publike. I njëjti amendament është hedhur në votim dhe nga Komisioni ad-hoc nuk i ka marrë 2/3 e votave. Prandaj, mbetet që seanca të vendos për më tej me votimin e vet.

Të gjitha ndryshimet e tjera që janë në amendamentet e propozuara para jush, besojmë se nuk kanë ndonjë kundërshtim, kanë harmonizim të plotë me Pakon gjithëpërfshirëse të Ahtisarit, me Kushtetutën e Kosovës dhe duhet të aprovohen nga seanca plenare.

Edhe një herë më lejon që t'i falënderoj gjithë anëtarët e Komisionit për punën e bërë, përkundër dallimeve dhe mendimeve të ndryshme në çështje të caktuara, të cilat, besoj se kanë ngritur një debat të mirë dhe seanca do të marrë vendimin meritator për çështjet që janë biseduar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mujota!

Nga kryetarët e grupeve parlamentare nuk është paraqitur askush për diskutim. Prandaj, ju ftoj që përmes votimit me elektronikë, ftoj teknikën të bëhet gati për votim. Votojmë tani për Ligjin e parë, pra për Projektligjin për Shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Teknika, gati për votim. Votojmë tani:

Konstatoj që "për" kanë votuar 56 deputetë, 12 kanë abstenuar dhe 3 janë kundër. Pra konstatoj që Ligji për Shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës u miratua me shumicë absolute të votave.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Rekomandimi i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Ftojmë, nëse ka nevojë, që të sqarojë kryetari i Komisionit, nëse jo, vazhdojmë me votimin, nëse nuk kanë diçka kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari i Komisionit ad-hoc thotë së s'ka nevojë për sqarime, i kemi miratuar dje.

Atëherë, as kryetarët e Grupeve parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim.

Ftoj teknikën që të bëhemi gati për votim. Votojmë tani:

Votim me dorë, 4 vota.

Konstatohet se me 71 vota "për", 1 "kundër" dhe 3 abstenime, u miratua në shqyrtimin e dytë Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Në qoftë se kryetari i Komisionit, zoti Mujota, ka diçka lidhur me këtë Ligj? Nuk ka nevojë. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim.

Ftoj teknikën që të bëhemi gati për votim. Votojmë tani:

Kemi 3 vota pa kartelë, 68 elektronike.

Konstatohet se me 71 vota "për", 1 "kundër" dhe 4 abstenime, u miratua Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Komisioni ad-hoc s'ka diçka të veçantë. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim.

Ftoj teknikën që të bëhet gati për votim. Votojmë tani:

Konstatohet se me 71 vota "për", 3 vota "kundër" dhe 4 abstenime, miratohet Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin pensional të Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Komisioni ad-hoc s'ka diçka për të sqaruar. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim.

Ftoj teknikën që të bëhet gati për votim. Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/2, për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave**

Komisioni Ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Nuk është paraqitur askush për diskutim. Ftoj regjinë që të bëhet gati për votim. Votojmë tani.

Konstatohet se me 70 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/16 për shpalljen e Ligjit për telekomunikacion, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës**

Komisioni Ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Fehmi Mujota, kryetar i Komisionit, është paraqitur për diskutim. Urdhëro, zotëri Mujota!

FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit, zotëri Kryesues,

Në fakt, unë e bëra shpjegimin në ekspozenë e parë, por meqë ka një kërkesë nga disa deputetë që të sqarohet edhe njëherë një çështje, atëherë po e marr për obligim të them që Komisioni ka shqyrtuar kërkesën, përkatësisht propozimet që kanë dalë dje në Seancën plenare, dhe për përkujtimin tuaj, të lexoj që Ministria, përkatësisht ministri

Limaj në seancën plenare ka pasur propozimin konkret në nenin 11, ku Ministria autorizohet që të lidhë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me organizata ndërkombëtare në fushën e telekomunikacionit dhe, po ashtu, nën 13 ka pasur propozim që të fshihet dhe të ngel ashtu si është në nenin 19. Këtë seancë e ka aprovuar dhe, në parim, ndërsa sot Komisioni ad-hoc në shqyrtimin e vet nuk i ka pasur 2/3 e votave për t'i aprovuar këto ndryshime që i ka aprovuar Seanca plenare dhe në parim. Natyrisht, për këto çështje është një shpjegim që është dhënë këtu, dhe arsyeja ishte ai që një pjesë e saj është e rregulluar me Kushtetutën e Kosovës, kurse pjesa tjetër me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe seanca duhet të votojë për pikën 2, ta aprovojë kështu si është, apo të mos e aprovojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Sipas Rregullores që e kemi miratuar, këtu mund të votohet propozimi i Komisionit ad-hoc. I ftoj deputetët që të paraqiten. Mirë. Kemi dy të paraqitur nga grupet parlamentare. Fjalën e ka deputeti dhe kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë Kosovës, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se e kemi një çështje shumë të qartë sot për të cilën votojmë. Çështja e parë është se votohen, do të thotë rekomandimet e Komisionit, fillimisht, ashtu siç thatë ju dhe pajtohem me ju. Nuk mund të ketë çështje të votimit për dy çështje, dhe çështja tjetër është, ne nuk e kemi ngritur çështjen më përpara, mirëpo sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, është shumë qartë e përcaktuar që amendamentet për një ligj nuk bëhen në lexim të parë, aq më tepër, nuk bëhen amendamente në Ligj me gojë, amendamentet bëhen me shkrim. Do të thotë, Komisioni ad-hoc prapë se prapë e ka marrë parasysh vendimin e djeshëm të Kuvendit të Kosovës, për atë që është thënë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të mos kalohet ashtu.

Nëse do të kalohet me një votim të dyfishtë, mendoj se do të jetë thyerje serioze e Rregullores së Punës së Kuvendit, Rregullore të cilën e kemi miratuar ne vetë për shkak se amendamentet në lexim të parë nuk paraqiten. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Mujota!

Pajtuemshëri të plotë me atë që thotë zotëri Gjini. Seanca duhet të votojë për pikën 2 dhe të marrë vendimin për të. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në qoftë se doni t'ua lexoj edhe një herë, po ua lexoj, që të mos humbim kohë me diskutime. Ne e kemi miratuar këtë Rregullore vetë dhe nuk është mirë të futemi në debat. Të gjithë e kemi votuar, prandaj unë përveç kryetarëve të grupeve parlamentare që e kanë kërkuar fjalën, dhe në radhë është Lutfi Haziri, dhe jam i obliguar t'ia jap fjalën, nuk e besoj se ka nevojë tjetër kush të diskutojë.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

U dhanë sqarime, sipas mocionit duhet të vazhdojmë të punojmë. Ne e kemi dëgjuar në një seancë të veçantë ministrin Limaj dhe është arsyeja e kësaj zhagitjeje që ndodhi sot pasdite, me qëllimin e vetëm që të sqarohet kjo.

Dje, jo rastësisht, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së unë kërkoja që ministri ta sqarojë para deputetëve propozimin e tij, dhe ky ka qenë se në spastrimin teknik, sipas marrëveshjes që ka pasur përfaqësuesi i Qeverisë me ekspertë të organizatave ndërkombëtare, që janë këtu, është tejkaluar në dy nene kjo kërkesë e Qeverisë. Ne e kemi debatuar sot në mëngjes prapë, por konstatimi i Komisionit ishte se kemi tejkalime në këto dy fusha për shkak Kushtetutës edhe të Ligjit që ka qenë, po ashtu, pjesë e punës sonë.

Sidoqoftë, nuk është mirëkuptuar deri në fund sqarimi që ka dhënë ministri Limaj, për arsye se ka dashur ta sqarojë drejt çka është menaxhimi dhe çka është monitorimi i politikave në rastin e dytë, e në rastin tjetër e drejta për të pasur nënshkrim të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Sidoqoftë, ne e kemi bërë, mocioni është i qartë, duhet të votohet sipas mocionit dhe kryesuesi e paraqiti në mënyrë korrekte atë. Ju faleminderit!

KRAESUESI: Ju faleminderit! Zoti Lulzim Zeneli, kryetar i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në përputhje me atë që e thanë edhe kolegët paraprak, ne duhet të procedojmë në përputhje të plotë me mocionin, të cilin e kemi miratuar, dhe assesi të mos interpretohet ndryshe këtu.

E pra, të drejtë ekskluzive për t'i paraqitur amendamentet në Seancë plenare ka Komisioni ad-hoc. Komisioni ad-hoc i ka dhënë rekomandimet e veta dhe ne, si Seancë plenare, mund t'i votojmë ose të mbeten ashtu qysh kanë qenë në Ligj. Do të thotë, i kemi dy mundësi. Ndërsa, këtu duhet të sqarohet fort mirë që amendamentet nuk mund të procedohen as nuk mund të diskutohen në leximin e parë. Leximi i dytë është periudha kur ne mund t'i miratojmë amendamentet përkatëse.

Komisioni funksional, Komisioni ad-hoc nuk ka dhënë ndonjë amendament, prandaj e ka rekomandimin çfarë e keni të shkruar dhe, ju lutem, të procedojmë më tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, ju i keni në pikën 2 rekomandimet e Komisionit në Projektligjin e shtatë, pikën 2, ku shkruan shumë mirë. Të gjithë e keni përpara dhe ju ftoj që, sipas mocionit, ta votojmë pikën 2 të Komisionit ad-hoc.

Teknika, gati për votim. Votojmë tani:

Pa kartelë - 6 deputetë. Prej nga dolën tash kaq shumë pa kartela?!

Unë ju kisha lutur që të mos votoni nga dy herë. Deri me tani kanë qenë vetëm 4 veta pa kartelë, e tash dolën më shumë pa kartelë. Unë dua të jem i sinqertë. E përsërisim votimin. Unë dua t'ua lexoj edhe një herë. Vota jonë është e lirë.

Komisioni shqyrtoi propozimet... Ju lutem uluni! Unë po dua ta përsërisim. Është një gabim i teknikës. A e doni këtë që është votuar, qysh është votuar. Ju lutem, uluni njëherë! Nuk keni nevojë të çoheni në këmbë, absolutisht. Ne mund ta konstatojmë saktë kuorumin.

Të lutem, zoti Gjini, mund të ulesh, nëse do të ta sjellin një kafe, ta sjellin, nuk ka problem... Unë, e kam hallin për hir të prezencës, sepse mua më dolën dy vota më shumë pa kartelë. Për atë thashë. OK.

Komisioni shqyrtoi propozimet e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, të miratuara në parim në Seancën plenare të 12 qershorit 2008, dhe të njëjtat i përkrahu për arsye se propozimi i parë është rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kurse propozimi i dytë është i rregulluar me Ligjin për ndërmarrjet publike.

(Ndërhyrje nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

Pse nuk kam të drejtë?

Po kam të drejtë ta qes. Unë e udhëheq seancën, e jo ti. Po, mos dash, del jashtë. Unë jam duke e udhëhequr seancën, e jo ti. Mund të dalësh jashtë, kur të dush!

(Reagime nga salla)

Ju lutem, dua të konstatoj saktë, sa veta janë pa kartelë në Kuvendin e Kosovës? 1, 2, 3, 4. Katër veta janë pa kartelë në Kuvendit. Asnjë votë më shumë se 4 nuk pranohet pa kartelë. Të lutem, konstato sa veta janë në Kuvend? Sa veta janë në sallë të Kuvendit që kanë për të votuar? Prezentë janë 78 deputetë. Ju ftoj që të votoni. Ju ftoj që ta votoni mocionin e Komisionit ad-hoc.

Kush është “për”?

Teknika gati. Votojmë tash:

Sa janë që votojnë “për”? Janë 36 me elektronikë, dhe 1 është pa elektronikë, bëjnë 37 vota “për”.

“Kundër” me elektronikë janë 31, pa elektronikë 3, bëjnë 34, do të thotë miratohet mocioni i Komisionit ad-hoc me 37 vota “për”, 34 “kundër” dhe 4 abstenime.

Pika e tetë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit të
Kuvendit të Kosovës, nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Komisioni ad-hoc, ka diçka? Nuk ka. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur.

Ftoj deputetët që të votojnë.

Teknika gati. Votojmë tani:

“Për” me elektronikë janë 57 vota.

Pa kartelë kush është “për”? Do të thotë, janë 60 vota “për”, 3 “kundër” dhe 6 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet publike

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendin ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Komisioni, a ka diçka të thotë? Jo. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk janë paraqitur. Komisioni e ka bërë një amendament, prandaj ju ftoj që ta votojmë amendamentin nr.1.

Teknika gati. Votojmë tani:

Me 57 vota “për”, me kartelë. Pa kartelë, kush është “për”? 59 vota janë “për”, 6 “kundër” dhe 4 abstenime. Konstatohet që amendamenti u miratua.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim për tekstin e Projektligjit, në tërësi, me amendamentin e miratuar.

Votojmë tash:

“Për” kanë votuar me kartelë 58 deputetë. Pra, 58 vota janë “për” ndërsa “kundër” janë 4 vota, 8 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për ndërmarrjet publike.

Vazhdojmë me pikën e 10-të:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2008/13 për miratimin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin dhe rekomandimet. Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Komisioni, a ka diçka? Nuk ka. Grupet parlamentare nuk janë paraqitur.

Atëherë, vazhdojmë me votimin për amendamentin nr. 1.

Ftoj teknikën që të jetë e gatshme për votim. Votojmë tani:

Me 65 vota “për”, 1 “kundër” dhe 10 abstenime, konstatohet se u miratua edhe amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit, në tërësi, me amendamentin e miratuar.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër” dhe 9 abstenime, konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, 2008/13 për miratimin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Siç e miratuam në fillim të seancës, është një kërkesë e Qeverisë që ta miratojmë me procedurë urgjente shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin e 7 ligjeve, në pjesën e hyrjes në fuqi, që do të thotë që në fund të çdo ligji të jetë teksti: “Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Materialet i keni marrë të gjithë. I votojmë propozimet në pako.

Ftoj teknikën që të bëhet gati për votim. Votojmë tani:

Me 69 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, konstatoj që edhe propozimet e Qeverisë për miratimin e tekstit shtesë në ligjet përkatëse i kemi miratuar. Ramë Buja e ka kërkuar fjalën.

RAMË BUJA: Kërkoj falje, meqë nuk e kam kartelën, dola në tribunë, por është bërë një gabim teknik, nuk është votuar fare për Ligjin nr. 7, është votuar vetëm për amendamentin dhe për mocionin dhe këtu duhet të korrigjohet kjo gjë. Nuk është votuar fare për Ligjin, te keni parasysh.

KRYESUESI: Ju faleminderit, Ramë, për ndihmën. Atëherë, votojmë edhe njëherë në tërësi Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Ju ftoj që të votojmë. Teknika gati. Votojmë tani:

Konstatoj që 37 vota janë “për”, 17 “kundër” dhe 3 abstenime.

Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 75 deputetë. Me 37 vota “për”, 17 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi edhe Ligjin për Telekomunikacionin, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Me kaq, përfundoi seanca e sotme.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve